REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM

Nr. 30, datë 29.10.2026

PËR
MIRATIMIN E "PASQYRAVE FINANCIARE TË "FONDIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME" PËR TREMUJORIN E TRETË TË MBYLLUR MË 30 SHTATOR 2026"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, pika 1, shkronja "m/1" të ligjit nr. 53/2014 "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar, të nenit 71 pika 2, të nenit 73, pika 1, dhe të nenit 79 të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016 "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë", të nenit 15, pika 1 dhe pika 5 dhe të nenit 18 pika 1 të Rregullores "Për fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij", të miratuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 56, datë 3.10.2017, të ndryshuar, të nenit 6, pika 2, shkronja "c", të nenit 8, pika 2, shkronja "l" të Statutit të Agjencisë, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 18, pika 2 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 "Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave", si dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Miratimin e "Pasqyrave financiare të "Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme" për tremujorin e tretë të mbyllur më 30 shtator 2026", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm për dërgimin e këtij vendimi në Autoritetin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

3. Ngarkohen Sektori i Financës dhe Investimeve dhe Sektori i Analizës të Riskut për zbatimin e këtij vendimi.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave
Rruga e Elbasanit, Nr. 317
Tiranë / Albania
t: +355 (4) 2362 989/2347 298 f: +355 (4) 2362 984
e: info@asd.gov.al w: www.asd.gov.al

4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Donald Duraj — Kryetar

Shqipe Malaj — Sekretare

Agjencia e Sigurimit të Depozitave
Rruga e Elbasanit, Nr. 317
Tiranë / Albania
t: +355 (4) 2362 989/2347 298 f: +355 (4) 2362 984
e: info@asd.gov.al w: www.asd.gov.al